



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.450/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Burim Ademi dhe Rrustem Thaqi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Blerta Peci, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Gjilan, paraqitur kundër subjektit politik Nisma Socialdemokrate me seli në Gjilan, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor - posterit në rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 15.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHET e bazuar ankesa A.nr.450/2021 e datës 14.02.2021 e ushtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Nisma Socialdemokrate me seli në Gjilan, për shkak të vendosjes së posterit për fushatën zgjedhore mbi kioskën, në oborrin e qendrës së votimit “Abaz Ajeti” në Gjilan gjatë heshtjes zgjedhore, i shqiptohet gjobë në lartësi prej 1,500.00 (njëmijë e pesëqind) euro, dhe detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimin të këtij vendimi nën kërcënim të dënimit shtesë.

A r s y e t i m

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Gjilan, ka parashtruar ankesë Anr.450/2021 me datë 14.02.2021, me të cilën pretendon se kandidati për deputet Isa Musliji nga radhët e subjektit politik Nisma Socialdemokrate, në oborrin e qendrës së votimit “Abaz Ajeti”-Gjilan, ka të vendosur postera me përmbajtje elektorale në zonën e ndaluar të përcaktuar. Me këtë rast nga ana e këtij subjekti është bërë shkelja e nenit 36 paragrafi 1 pika b) i LZP-së si dhe nenin 8 par.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur disa fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 14.02.2021, subjekti politik Nisma Socialdemokrate, konstaton se posterit me përmbajtje elektorale të kandidatit Isa Musliji nga Gjilani, nuk është vendosur nga kandidati në fjalë e as nga mbështetësit e tij apo nga aktivistët e degës në Nisma Socialdemokrate në Gjilan. Nisma Socialdemokrate thekson se me të marrë ankesën nga PZAP, kanë vepruar menjëherë dhe aktivistët e tyre i kanë larguar posterët nga vendi ku janë vendosur.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli pas shqyrtimit të shkresave, e posaçërisht nga fotot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se materialet zgjedhore-posteri i kandidatit për deputet nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate, është vendosur në hapësirat publike-rrugë, përkatësisht në oborrin e qendrës së votimit “Abaz Ajeti”- Gjilan, gjatë heshtjes zgjedhore, veprim ky që është në kundërshtim me nenit 36 paragrafi 1 pika b) i LZP-së, e cila përcakton “Njëzet e katër orë

(24) para hapjes së qendrave të votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohej secili prej veprimeve u ndalohej secili prej veprimeve si; a) shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, ose 100 metra brenda hapësirës së të njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi tek votuesit; b) bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”.

Paneli, vendimin e tij e ka mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, prandaj pretendimet në përgjigje në ankesë nuk u cilësuan me ndikim në meritat e lëndës.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalët, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin së subjekti politik Nisma Socialdemokrate, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e rregullave dhe Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me Rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik Nisma Socialdemokrate, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin jo relevante dhe pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që është vendos.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr. 450/2021 më datën 15.02.2021

Kryesuesi i Panelit

Zyhdi Haziu



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së,